



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo –Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura V**  
**Sesioni vjeshtor**

---

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 12 dhjetor 2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

**P r o c e s v e r b a l**

**i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

**Në mbledhje morën pjesë:** Elmi Reçica, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Puhie Demaku, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

**Munguan:** Teuta Rugova, Qerim Bajrami dhe Ismet Beqiri.

**Nga zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Jeta Krasniqi, Artan Murati, Violeta Haxholli dhe Fjolla Uka, KDI; Vlora Nushi, UNMIK-OPA; Blerta Bejtullahu, EUSR/EU Office; Endrit Bytyçi, PIPS; Shefki Kastrati, NDI; Naim Jakaj dhe Gurjeta Zeka, LVV; Argjend Zejnaj, GP/AAK dhe Taulant Salihu, KREK.

**Mbledhjen e kryesoi:** Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Situata aktuale në Mitrovicë;
3. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi rendin e ditës.

**2. Situata aktuale në Mitrovicë**

**Elmi Reçica**, njoftoi se më 2 dhjetor, Komisioni, në bashkëpunim me KDI-në, ka organizuar një tryezë në Mitrovicë, ku janë parë punët rreth projektit për hapjen e urës së Mitrovicës, është vizituar pjesa

veriore e Mitrovicës, por askund nuk është vërejtur marketa e urës. Kryetari, si çështje shqetësuese, ngriti mosinformimin e deputetëve dhe të qytetarëve të Kosovës lidhur me projektin e plotë dhe të saktë të ndërtimeve që po bëhen në atë pjesë. Lidhur me tryezën e mbajtur në Mitrovicë, njoftoi se të pranishëm ishin z. Agim Bahtiri, kryetar i Komunës së Mitrovicës në jug dhe znj. Adriana Hoxhiq, përfaqësuese e Komunës së Mitrovicës në veri. Atje është biseduar për nevojën që qytetarët të jenë më të njoftuar për vendimet, marrëveshjet dhe të gjitha detajet për të cilat po bisedohen në Bruksel, e po ashtu është kërkuar që para Kuvendit dhe Komisionit të raportohet në periudha të caktuara.

**Puhie Demaku**, shprehu keqardhje që kjo çështje po diskutohet në Komision, ngase kjo çështje duhet të trajtohet në Kuvendin e Kosovës. Ajo tha se Kuvendi duhet ta thërret në përgjegjësi Qeverinë e Kosovës, sepse me ndërtimin e murit është prekur thellësisht sovraniteti dhe integriteti territorial i vendit. Sipas saj, dialogu është filluar, me qëllim të unifikimit të vendit dhe përsheptimin e proceseve integruese në BE, por këto kanë dështuar dhe me ndërtimin e këtij muri, është betonuar ndarja e vendit. Znj. Demaku, tha se ministrja për Dialog, para çdo raportimi në Komision, ka folur për sukseset dhe se si marrëveshjet po e ndihmojnë Kosovën, kurse tash po del se me murin paska shumë të fshehura prapa këtij procesi. Ajo njoftoi se Lëvizja Vetëvendosje ka dorëzuar kërkesën për interpelancë të Kryeministrit Mustafa dhe se Komisioni duhet ta mbështesë këtë iniciativë.

**Zafir Berisha**, për ndërtimin e murit, tha se kjo është vazhdimësi e projekteve të Serbisë për ndarjen e Kosovës. Ai tha se në vitet 1999 - 2000 në Mitrovicë është bërë pastrim etnik nga forcat kriminale të mbështetura nga Beogradi, që ka pasuar me bllokimin e urës, me parkun e paqes, e deri tek ky mur. Më tej shtoi se dialogu me Serbinë është një gabim i madh i bërë nga institucionet e Kosovës, sepse Serbinë e kanë bërë partnere diskutimin e çështjeve të brendshme të Kosovës. Shprehu mendimin se Komisioni duhet t'i propozojë Kuvendit që të marrë vendim për ndërprerjen e bisedimeve dhe të formojë një komisionad-hoc për rishikimin e të gjitha marrëveshjeve që janë nënshkruar, kurse ata që e kanë shkëlur Kushtetutën dhe ligjet e vendit, të përgjigjen para organeve të drejtësisë.

**Elmi Reçica**, tha se është e njohur për të gjithë se si kanë filluar bisedimet, merezolutën e Këshillit të Sigurimit, e cila thotë se pas vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare, e cila e njeh legjitimitetin dhe legalitetin e shpalljes së pavarësisë, të fillojnë bisedimet. Lidhur me propozimin e deputetit Berisha për ndërprerjen e bisedimeve, z. Reçica tha se nuk na bënë mirë që të kërkojmë ndërprerjen e tyre, por ne mund të kërkojmë nga Qeveria që të raportojë me shkrim dhe të shohim se çfarë vendimesh po merren dhe çfarë veprimesh po bëhen. Më tej, tha se strukturat paralele nuk janë shuar të gjitha, por atje vërehet se është fuqizuar prezenca e institucioneve të Republikës së Kosovës. Po ashtu, z. Reçica shtoi se nuk e përkrah kërkesën për ndërprerjen e bisedimeve, por të kërkohet nga institucionet përgjegjëse që të informojnë Komisionin për të gjitha proceset që po zhvillohen.

**Pal Lekaj**, njoftoi se Grupi Parlamentar i AAK-së, ka marrë iniciativë për thirrjen e një seance të jashtëzakonshme lidhur me këtë rast, mirëpo përpos Grupit Parlamentar NISMA-s, nuk ka gjetur mbështetje nga grupet tjera parlamentare. Lidhur me ndërtimin e murit, tha se së bashku me kryetarin e Komisionit ishin atje, mirëpo nuk janë informuar nga kryetari i Komunës lidhur me ndërtimin e tij, e po ashtu nuk janë informuar se si do të bëhet rivitalizimi i urës. Po ashtu, tha se marrëveshjet janë nënshkruar larg Kuvendit dhe deputetëve dhe shtoi se AAK ka bërë të qartë se është për ndërprerjen e dialogut të këtij lloji, se duhet të rishikohet formati dhe marrëveshjet e arritura. Lidhur me deklaratat e ministres Tahiri, se nuk do t'i përgjigjet ftesës për interpelancë, meqë do ta rrënojë murin, z. Lekaj tha

se po të ishin më vigjilentë, nuk do të ishte ndërtuar fare ky mur. Shprehu mendimin se në marrëveshjen për rivitalizimin e urës ekziston edhe ndërtimi i murit dhe se deputetët dhe qytetarët e Kosovës nuk janë të informuar. Kërkoj që Komisioni të dalë me konkluzione për ndërprerjen e dialogut, derisa të sqarohet marrëveshja për rivitalizimin e urës, të ndërpriten punimet në atë pjesë dhe marrëveshjet e arritura të sqarohen në Kuvend. Z. Lekaj, në fund, shtoi se çdo marrëveshje para se të nënshkruhet, duhet të silllet në Kuvend, në mënyrë që deputetët ta trajtojnë atë dhe pastaj të nënshkruhet.

**Elmi Reçica**, sa i përket propozimeve për ndërprerjen e dialogut, tha se dialogu nuk ka alternativë tjetër. Komisioni duhet të kërkojë transparencë e llogaridhënie dhe të mbikëqyrë procesin e dialogut, shtoi z. Reçica. Sa i përket ndërtimit të murit, njoftoi se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka marrë vendim që ky mur është i paligjshëm dhe Komisioni duhet të kërkojë nga organet kompetente ta zbatojnë atë.

**Pal Lekaj**, tha se dialogu duhet të bëhet në interes të Kosovës, duke mos pretenduar në territore tjera, mirëpo ky dialog, në këtë formë, është i dështuar, sepse po bëhet pa një kornizë të caktuar, pa afatizim dhe nuk i është dhënë rëndësi interesit të qytetarëve të Kosovës. Ai tha se Serbia ka liberalizim të vizave dhe ka përkrahjen e BE-së për marrëveshjet e arritura me Kosovën, ndërsa Kosova ka mbetur e izoluar, prandaj është dashur të vendoset një kornizë dhe të kërkohej njohja nga vendet e BE-së, njohja e Serbisë ndaj Kosovës dhe të tjera.

**Luljeta Veselaj-Gutaj**, tha se situata në Mitrovicë është e rënduar dhe të gjithë janë të shqetësuar për vënien e atij muri dhe mosrespektimin e marrëveshjeve. Shprehu mendimin se bisedimet duhet të vazhdojnë, sepse janë në të mirën e shtetit, mirëpo institucionet përgjegjëse, marrëveshjet dhe bisedimet duhet të jenë transparente para Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës. Znj. Veselaj-Gutaj, tha se ne duhet të kërkojmë nga BE-ja, që ata të insistojnë që Serbia t'i respektojë dhe t'izbatojë marrëveshjet e arritura. Po ashtu, tha se Komisioni duhet të kërkojë raport me shkrim nga ministrja Tahiri dhe pastaj të thirret në raportim para Komisionit.

**Blerta Deliu-Kodra**, tha se ndërtimi i murit është shqetësim i institucioneve dhe ka prekur rëndë sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit. Shprehu mendimin se duhet të ketë raportim dhe transparencë nga institucionet përgjegjëse dhe se nuk sheh asgjë negative që kjo çështje të ngrihet edhe në Kuvend. Ajo tha se e mirëpret vendimin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për rrënimin e murit dhe duhet të kërkohet nga institucionet që të zbatohet ky vendim. Znj. Deliu-Kodra, deklaroi kryetarit të Mitrovicës në veri, i cilësoi shqetësues, i cili ka deklaruar se nuk do të ketë rrënim të murit, por vetëm ulje në 70cm. Shprehu keqardhjen që deputetët e Kuvendit, për një çështje kaq të ndjeshme, informohen vetëm nga mediat dhe kërkoj nga institucionet përgjegjëse dhe Zyra e BE-së, që të informohen se çfarë po ndodh atje. Në fund, znj. Deliu-Kodra shtoi pyetjen se a ka ndonjë marrëveshje për ndërtimin e këtij muri apo është një veprim ilegal nga strukturat e atjeshme për të cilat ne si institucione duhet të marrim masa?

**Zafir Berisha**, tha se me Serbinë duhet të bisedohet për fatin e 1600 qytetarëve të zhdukur, për dëmet materiale që i ka bërë në Kosovë, e jo për çështje të brendshme të Kosovës. Lidhur me ndërprerjen e bisedimeve, tha se bisedimet duhet të ndërpriten në kuptimin e asaj që të marrin njëkaheje dhe shprehu mendimin se Kosova duhet të ndryshojë qasjen e saj ndaj bisedimeve me Serbinë. Po ashtu, tha se Serbia, në raport me Kosovën, mbetet shtet fashist dhe këndvështrimi i saj politik ndaj Kosovës është i

njëjtë me atë të Millosheviçit. Ai kërkoi që përmes debatit konstruktiv në Komision dhe në Kuvend, të merren qëndrime dhe vendime të qarta, të cilat do ta ndryshojnë kahun dhe sjelljen e Kosovës në raport me Serbinë.

**Elmi Reçica**, tha se në Bruksel jemi shtet dhe palë e barabartë dhe se ne e përcaktojmë se kush e përfaqëson Kosovën atje. Ne duhet të informohemi për vendimet e marra, për zbatimin e tyre dhe duhet të kërkojmë nga BE-ja, si lehtësues i këtyre bisedimeve, që të jetë më i vendosur në raport me marrëveshjet e arritura dhe zbatimin e tyre, tha z. Reçica.

**Pal Lekaj**, tha se nuk pajtohet kur përmendet barazia në Bruksel, sepse edhe vetë ministrat e Qeverisë së Kosovës nuk e njohin Kosovën si shtet, por iu referohen asaj si krahinë autonome apo krahinë e Serbisë dhe askush nuk merr vendim për qortimin e tyre.

**Blerta Deliu-Kodra**, njoftoi se në Asamblenë Parlamentare të Evropës Juglindore, Kosova do ta udhëheqë Komisionin për Energjetikë dhe Ekonomi dhe se ky dialog, në shumë nisma, ka prodhuar efekte pozitive. Ndërsa, sa i përket rastit në Mitrovicë, tha se është rast tjetër, aq më tepër kur institucionet që janë atje po ndihmojnë në izolimin dhe ndarjen e asaj pjese. Ajo propozoi që të ftohet për raportim ministrja për Dialog dhe të gjithë mekanizmat që janë të obliguar t'i zbatojnë ato marrëveshje. Shprehu mendimin se Komisioni duhet të kërkojë zbatimin e vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të ketë raportim me shkrim dhe të bisedohet edhe në seancën plenare.

**Puhie Demaku**, tha se mandati i Komisionit është i kufizuar, sa i përket këtij debati, prandaj duhet të diskutohet në seancë plenare. Ajo tha se pajtohet që të ketë raportim në Komision, por ky raportim të bëhet me dokumente konkrete, sepse deputetët asnjëherë nuk kanë marrë ndonjë dokument, në mënyrë institucionale. Më tej, theksoi se dokumentet lidhur me marrëveshjet, i kanë marrë nga KDI-ja, ku edhe thuhet që marrëveshja për rivitalizimin e urës e ka edhe planin arkitekturor, kurse deputetët nuk e kanë as marrëveshjen, as planin. Znj. Demaku, po ashtu, njoftoi se në nëntor të vitit 2015, është dorëzuar në Kuvend peticioni me 205 000 nënshkrime, ku ndër të tjera është kërkuar edhe tërheqja nga marrëveshjet, mirëpo Kuvendi ka bërë shkelje, sepse nuk e ka shqyrtuar kurrë këtë peticion.

**Elmi Reçica**, tha se interpelanca është e domosdoshme të ndodhë, por të mos mohohen të arriturat e dialogut. Ky mandat është më ndryshe se mandatet tjera, shtoi z. Reçica, sepse ndikimi i Serbisë në ministrat dhe deputetët e Kosovës është i qartë, mirëpo nuk duhet të kthehemi mbrapa. Z. Reçica, tha se kemi mendime të ndryshme sa i përket dialogut, mirëpo jemi unik sa i përket asaj që të kërkojmë më shumë transparencë, jo vetëm sa i përket dialogut, por edhe çështjeve tjera që janë me interes për Komisionin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

---

Elmi Reçica